

1 KRYERJA E TESTIT

Nëse kryerja e testit bëhet në ditën e caktuar të periodave të pritshme, ju mund ta realizoni atë në çdo moment të ditës.


Nëse testi realizohet përpara datës së caktuar të periodave të pritshme, përdorni urinën e parë të ditës.

- Në momentin e kryerjes së testit, hiqni shkopin e testit nga mbështjellja prej letre dhe hiqni kapakun me ngjyrë blu. Përdorni menjëherë shkopin e testit.



2 PRISNI 2 MINUTA

- Një vijë me ngjyrë blu në dritaren e kontrollit tregon se testi ka funksionuar.
- Ju mund të lexoni rezultatin pas **2 minutash**.
- Mos e lexoni rezultatin deri në momentin e shfaqjes së kësaj vije blu.
- Nëse vija blu nuk shfaqet në dritaren e kontrollit brenda **10 minutash** testi nuk ka funksionuar (referojuni pyetjes 6).



3 LEXIMI I REZULTATIT

Tashmë mund ta lexoni rezultatin në dritaren e rezultatit.



Nëse rezultati që merni është 'Shtatzënë' referojuni pyetjes 9 në seksionin e Pyetjeve dhe Përgjigjeve.
Nëse rezultati që merni është 'Jo Shtatzënë' referojuni pyetjes 10 në seksionin e Pyetjeve dhe Përgjigjeve.



Mund të lindë nevoja për të zëvendësuar kapakun.

Referojuni pyetjes 5 nëse maja e ndryshimit të ngjyrës nuk merr plotësisht ngjyrë rozë.

KINI PARASYSH! Lexoni rezultatin e testit brenda **2-10 minutash** pas kryerjes së testit. Mos merni në konsideratë ndryshimet në rezultatin e testit pas kësaj kohe. **Pyetje dhe Përgjigje** - Lexoni seksionin e mëposhtëm që u përgjigjet pyetjeve më kryesore.

Nuk është e rëndësishme nëse ndonjë prej vijave që përbëjnë simbolin '+' ka ngjyrë më të hapur apo më të errët se tjetra; rezultati është 'Shtatzënë'.



Nëse ende jeni të pasigurt për rezultatin referojuni pyetjes 7 për detaje të plota.

Pyetje dhe Përgjigje

- Cila është shkalla e saktësisë së Clearblue®?**
Clearblue® ka një saktësi që tejkalon 99% në analizat laboratorike, kur përdoret në datën e periodave të pritshme.
- Si funksionon Clearblue®?**
Gjatë shtatzënisë trupi juaj prodhon hormonin e shtatzënisë hCG (Gonadotropina korionike njerëzore). Niveli i hCG-së në trupin tuaj pëson rritje në fazat e hershme të shtatzënisë. Clearblue® është në gjendje të zbulojë sasi shumë të vogla të këtij hormoni në urinën tuaj, duke filluar nga data e pritshme e periodave (ndjeshmëria e këtij testi është 25 mIU/ml).
- Kur mund ta kryej testin me Clearblue®?**
Clearblue® mund të përdoret deri në 5 ditë para periodave të munguara (që është 4 ditë para periodave të pritshme). Nëse kryeni testin para datës së periodave të pritshme dhe merni rezultatin 'Jo Shtatzënë', ka ende mundësi që të jeni shtatzënë. Shihni tabelën e mëposhtme për rezultatet e arritura nga testimet klinike të Clearblue® me ekzemplarë të hershëm të shtatzënisë.

Testimi i parakohshëm

Numeri i ditëve para periodave të pritshme	-1	-2	-3	-4
% e ekzemplarëve të marrë nga gratë shtatzëna që kanë marrë rezultatin 'Shtatzënë'	87 %	84 %	74 %	53 %

Për të gjetur ditën kur priten periodat, llogaritni kohëzgjatjen e zakonshme të ciklit tuaj menstrual duke numëruar numrin e ditëve nga dita e parë e periodave deri në ditën që i paraprin fillimit të periodave të ardhshme.

- Nëse keni cikle të rregullta, duhet të merni në konsideratë ciklin më të gjatë në muajt e fundit para kryerjes së testit.
- Nëse nuk e dini kohën e periodave, ju rekomandojmë kryerjen e testit jo më pak se 19 ditë pas herës së fundit gjatë të cilës keni pasur marrëdhënje seksuale të pambrujtur.
- Shmangni marrjen e tepruar të lëngjeve para kryerjes së testit.
- Nëse rezultati është 'Jo Shtatzënë' dhe ende dyshohet për shtatzëni të mundshme, referojuni pyetjes 10.
- A ka mundësi që ndonjë ilaç ose problem të caktuar mjekësor të ndikojnë në rezultatin e testit?**
 - Lexoni gjithmonë udhëzimet e prodhuesit për çdo mjekim që merrni përpara kryerjes së testit.
 - Ilaçet e fertilitetit me përbërja hCG mund të çojnë në rezultate të gabuara (këto barna fertilitetit zakonisht jepen me injeksion dhe kryerja e testit brenda një kohe të shkurtër pas marrjes së ilačit mund të japë një rezultat të rremë 'Shtatzënë').
 - Terapi të tjera të fertilitetit (të lilla si citrat klomifeni), qetësuesit e dhimbjeve dhe kontracetivët hormonalë (p.sh. pilula kontracetive) nuk duhet të ndikojnë në rezultat.
 - Nëse kohët e fundit ju nuk përdorni më kontracetivët hormonalë ose po përdorni terapi fertiliteti si citrat klomifeni, periodat mund të jetë të rregullta, duke ju çuar në kryerjen e parakohshme të testit.

- Nëse keni qenë kohët e fundit shtatzënë (edhe në rast se keni dështuar), mund të merni një rezultat të rreme 'Shtatzënë'.
- Shtatzënia ektopike, cistet në vezore, menopauza dhe disa probleme shumë të rralla mjekësore mund të çojnë në rezultate çorientuese.
- Nëse rezultati 'Shtatzënë' ka mundësi që më vonë të zbuloni se nuk jeni shtatzënë për shkak të humbjes natyrore të shtatzënisë që mund të ndodhë në fazat e hershme.

Nëse keni rezultate të paparashikuara, duhet t'i diskutoni ato me doktorin tuaj.

- Unë përdora testin, por maja e ndryshimit të ngjyrës nuk u shndërrua plotësisht në rozë. Çfarë duhet të bëj?**
Nëse maja e ndryshimit të ngjyrës nuk shndërrohet plotësisht në rozë, ka mundësi të mos keni aplikuar mjaftueshëm urinë. Gjithsesi, nëse vija blu në dritaren e kontrollit shfaqet brenda harkut kohor prej 10 minutash pas kryerjes së testit, atëherë testi ka funksionuar. Nëse vija blu nuk shfaqet në dritaren e kontrollit brenda 10 minutash pas kryerjes së testit, referojuni pyetjes 6.
- Unë përdora testin, por asnjë vijë blu nuk u shfaq në dritaren e kontrollit. Çfarë duhet të bëj?**
Nëse vija blu nuk shfaqet në dritaren e kontrollit brenda harkut kohor prej 10 minutash pas kryerjes së testit, atëherë testi nuk ka funksionuar. Kjo mund të ndodhë për shkak se:
 - Maja e ndryshimit të ngjyrës nuk është mbajtur e pozicionuar poshtë ose shkopi i testit nuk është mbajtur drejt pas aplikimit të urinës.
 - Është përdorur më shumë ose më pak urinë se sa duhet. **Ju duhet të testoni për 5 sekonda.**
 Ju duhet të kryeni përsëri testin, duke përdorur një test të ri dhe duke pasur kujdes që të ndiqni udhëzimet. Mund të lindë nevoja të mbledhni një ekzemplar të urinës tuaj në një enë të pastër, të thatë dhe të zhytni vetëm majën e ndryshimit të ngjyrës për vetëm 5 sekonda.
- Çfarë ndodh nëse unë nuk jam e sigurt për rezultatin e testit?**
 - Që rezultati të dalë 'Shtatzënë' duhet të ketë një vijë blu në dritaren e kontrollit dhe një simbol '+' në dritaren e rezultatit brenda 10 minutash nga kryerja e testit.

Shfaqja e simbolit '+' në dritaren e rezultatit mund të ndryshojë, gjithsesi, vijat që formojnë simbolin '+' dhe vija në dritaren e kontrollit duhet të kenë një gjëresë të përafërt (shih figurat A-C).

- Figura A**
Ka më shumë gjasa që kjo të ndodhë kur jeni shtatzënë dhe po kryeni testin jo më larg se disa ditë pas periodave të pritshme duke qenë se nivelet e hCG janë më të larta.
- Figura B**
Kjo nuk është e pazakontë kur jeni shtatzënë dhe po kryeni testin ose rreth ditës së periodave të pritshme duke qenë se nivelet e hCG janë ende relativisht të ulëta.
- Figura C**
Ende tregon rezultatin 'Shtatzënë'. Nëse jeni ende e pasigurt për rezultatin, duhet të prisni të paktën 3 ditë përpara kryerjes përsëri të testit, duke pasur kujdes që të ndiqni udhëzimet.

- Që rezultati të jetë 'Jo Shtatzënë' duhet të ketë një vijë blu në dritaren e kontrollit dhe një simbol '-' në dritaren e rezultatit brenda 10 minutash nga kryerja e testit. Nëse rezultati është 'Jo Shtatzënë' dhe përsëri dyshohet për shtatzëni të mundshme, referojuni pyetjes 10.

- Sa kohë është i dukshëm rezultati?**
Rezultati mund të lexohet në çdo moment deri në 10 minuta pas kryerjes së testit. Pas 10 minutash çdo ndryshim në rezultat nuk duhet të merret më në konsideratë.
- Testi im thotë se unë jam 'Shtatzënë'. Çfarë duhet të bëj?**
Nëse testi konfirmon se jeni shtatzënë, ju duhet të takoni mjekun tuaj i cili mund t'ju këshillojë për veprimet dhe hapat që duhet të ndërmerrni në të ardhmen.
- Testi im thotë se unë jam 'Jo Shtatzënë'. Çfarë duhet të bëj?**
Ju mund të mos jeni shtatzënë, ka mundësi që niveli i hormonit të shtatzënisë të mos jetë ende mjaft i lartë aq sa për t'u zbuluar, ose mund të keni llogaritur gabim ditën e periodave të pritshme. Nëse periodat ju janë vonuar, kryeni përsëri testin brenda një periudhe 3 ditore nëse ende dyshohet për shtatzëni të mundshme. Nëse ky test rezulton 'Jo Shtatzënë' dhe ende nuk ju vijnë periodat, bëni një vizitë të mjeku.

IVD	Pajisje mjekësore diagnostikuese in vitro	LOT	Kodi i ngarkesës	Ndalohet ripërdorimi
	Limiti i temperaturës 2°C - 30°C		Përdorimi deri në datën	Prodhuuesi
				Konsultohuni me udhëzimet e përdorimit

:SPD Swiss Precision Diagnostics GmbH (SPD),
Route de St Georges 47, 1213 Petit-Lancy, Gjenevë, Zvicër.
Clearblue është markë tregtare e SPD. Prodhuar në Kinë.

© 2015 SPD. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Shpërndarë nga: OVLAŠTENI ZASTUPNIK ZA RH: Orbico d.o.o. Koturaška 69, Zagreb, Kroacia

www.clearblue.com

Kjo pajisje këshillohet për përdorim shtëpiak. Ruajeni në temperaturën e dhomës. Mbajeni larg fëmijëve. Vetëm për përdorim diagnostikues in vitro. Hidheni me mbeturinat normale shtëpiake. Mos e përdorni nëse mbështjellësa e fletës është e dëmtuar.

Mos e përdorni nëse shkopi të testit i ka kaluar afati i skadimit.